

Përmbledhje



VENDIMMARRJA E GJYKATËS SË APELIT TIRANË NXIT TRUPËN GJYKUESE TË KPK PËR TË KËRKUAR SPJEGIME TË DETAJUARA GJATË SEANCËS SË RIVLERËSIMIT PËR ARMELA HASANTARI, GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 23/11/2022 PRANË KPK:**

Proçesi i rivlerësimit për subjektin është realizuar bazuar në të tre kriteret: kriteri i pasurisë, kriteri i kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016., ku institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, janë paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit.

Qëndrimet subjektive dhe personale të shprehura nga kryesuesja e trupes gjyquese, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar, krijojnë premisa për cënim të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 të Kushtetutës dhe 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Publiku ka depozituar pranë KPK 4 denoncime, por pas hetimit administrativ asnjë shkelje procedural nuk ishte konstatuar në asnjë prej rasteve.



**Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë nxit trupën gjyquese të KPK për të kërkuar
spjegime të detajuara gjatë seancës së rivlerësimit të subjektit znj. Armela Hasantari,
gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Më datë 23 nëntor 2022 ora 10:00, në KPK, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit znj. Armela Hasantari, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Trupi gjykues përbëhej nga znj. Genta Tafa Bungo (Kryesuese), z. Lulzim Hamitaj (Relator) dhe znj. Valbona Sanxhaktari (Anëtare), si dhe u asistua nga vëzhguesja ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej personalisht, pa praninë e një përfaqësuesi ligjor. Prej znj. Hasantari nuk u ngritën kërkesa paraprake në adresë të trupës gjyquese, mbi njëanshmërinë gjatë procesit apo konflikt interesi të ndonjë prej anëtarëve. Bazuar në nenet 45-47 K.Pr.A. dhe 49 pika 1/b të ligjit nr. 84/2016, pas njohjes me dosjen dhe dokumentacionin e rivlerësimit, subjektit i ishte kaluar barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, por asnjë fakt i ri nuk ishte depozituar.

Nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI, KLGJ dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Mungesa e deklarimit të burimit të pjesshëm të krijimit të një depozite bankare, në Deklaratën Vetting, u relatua si jo e provuar, por ky konstatim u kundërshtua nga subjekti, e cila ka depozituar spjegime me shkrim.

Nga hetimi administrativ i realizuar nga KPK, sipas nenit E të Aneksit Kushtetues, spjegime u kërkuar nga ana e subjektit edhe mbi vendimmarrjen e prishur e të rikthyer për gjykim me tjetër trupë gjyquese, nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, e kishte konsideruar shkelje procedurale vendimin e dhënë nga znj. Hasantari, në mungesë të palës së paditur. Subjekti i rivlerësimit shfaqti qëndrim mbi ligjshmërinë e vendimit të dhënë, duke qenë se njoftimi i të paditurit është realizuar në prezencë të një dëshmitari.

Vëzhguesi i KShH konstatoi se ndërhyrja nga kryesuesja e trupës gjyquese, duke e cituar vendimin e Gjykatës së Apelit si të drejtë, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit shprehte spjegimin e qëndrimit e tij, shfaq tendencë paragjyquese mbi çështjen dhe krijon baza për cënim të paanësisë së procesit. Qëndrimet subjektive dhe personale të shprehura, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar, krijojnë premisa për cënim të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 të Kushtetutës dhe 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Publiku ka depozituar pranë KPK 4 denoncime, të cilat janë hetuar nga Komisioni pas administrimit të dosjeve dhe akteve relevante gjyqësore, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioni relatoi një shkrim publik online, por pas hetimit administrativ asnjë shkelje procedurale nuk ishte konstatuar në asnjë prej rasteve.

Komisioni në seancën për shpallje vendimi 25 Nëntor 2022, ka konfirmuar në detyrë gjyqtaren znj. Armela Hasantari.